



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA	
QEVERIA E KOSOVËS-VLADA KOSOVA-GOVERNMENT OF KOSOVA	
MINISTRIA E SHËNDETËSISË-MINISTARSTVO ZDRAVLJA-MINISTRY OF HEALTH	
Njësia Org. Org.Jedinica Org Unit	01
Nr. Prot: Broj Prot: Prot.No:	05-6309
Nr.i faqeve Br.stranica No.pages	-2-
Data: Datum: Date:	13/08/2024
Prishtinë / a	

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government

Ministria e Shëndetësisë-Ministarstvo Zdravstva-Ministry of Health
Zyra e Ministrit- Ured Ministra -Office of the Minister

Nr:160/VIII/2024

Datë: 13.08.2024

Ministri i Shëndetësisë, në mbështetje të nenit 145, pika 2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në përputhje me nenet 10 dhe 11 të Ligjit nr. 06/L-113 për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore dhe agjencive të pavarura (Gazeta Zyrtare, Nr. 7, 01 Mars 2019), nenit 11 paragrafi 1.5 i Ligjit nr.08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, Rregullores (QRK) Nr.14/2023 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, në bazë të nenit 12, paragrafi 1.10 të Ligjit Nr. 04/L-125 për shëndetësi, në zbatim të Ligjit nr. 02/L-78 për shëndetësi publike, nxjerr këtë:

V E N D I M

për aprovimin e rekomandimeve të sotme të IKSHPK-së


1. Nga data 14.08.2024, deri me 17.08.2024 kufizohet orari i punës;
 - 1.1 Gjatë kësaj periudhe të nxehtësisë ekstreme, rekomandohet që të ndryshohen orarët e punës për të shmangur punën në orët më të nxehta të ditës, nga ora 11:00 deri në 16:00;
 - 1.2 Të aplikohet orari fleksibël i punës që nënkupton lejimin e punëtorëve që të fillojnë punën më herët në mëngjes ose të punojnë nga shtëpia nëse ka mundësi;
 - 1.3 Shtatzënat të lirohen nga puna gjatë orëve të pikut të nxehtësisë 11:00-16:00, ose të punojnë nga shtëpia;
 - 1.4 Në orarët 11:00 - 16:00 ndalohet puna për qytetarët e prekur me sëmundje kronike, apo të punojnë nga shtëpia;
 - 1.5 Të ndalohen punimet në sektorin e ndertimtarisë, që janë të ekspozuara në diell gjatë orarit 11:00-16:00;
 - 1.6 Të shpërndahen informacione përmes burimeve të informimit dhe broshurave e materialeve të tjera informuese për qytetarët për mënyrat e mbrojtjes nga nxehtësia;
 - 1.7 Të sigurohen kontrolla mjekësore për të punësuarit që tregojnë shenja të stresit nga nxehtësia dhe që i janë ekspozuar nxehtësisë ekstreme;
 - 1.8 Ata që merren me punët në bujqësi, të planifikojnë zhvillimin e tyre në mëngjes herët ose pasdite vonë për të shmangur ekspozimin në nxehtësinë e madhe;
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Duke u bazuar në rekomandimet e Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës për ndërmarrjen e masave për shkak të temperaturave të larta, që mund të ndikojë në aktivitetet e përditshme dhe të cilat paraqesin rrezik serioz për shëndetin dhe mirëqenien e njerëzve, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Dr. Arben Vitia

Ministër i Shëndetësisë



Vendim i dërgohet:

- *Kabinetit të Ministrit ;*
- *Zëvendës ministrave;*
- *Sekretarit të Përgjithshëm;*
- *IKSHPK-së;*
- *Divizionit për komunikim;*
- *Departamentit ligjor;*
- *Arkivit të MSh-së.*
- *Inspektoratit të Punës*